

Disa teknikat për zhvillimin e kompetencës fonologjike

Hyrje

Nga njëra fazë në tjetrën dhe sidomos përmes lojërave, fëmijët mësojnë rreth gjuhës së tyre, njohuri të cilat vinë e zgjerohen hap pas hapi. Pas përballjes me tingujt, rrokjet a fjalët, ata mësojnë për marrëdhënien e fjalëve me njëra tjetrën, për mënyrën se si bashkohen ato për të formuar fjali etj., duke e pasuruar kështu këtë gjuhë. Por, ligjërimi nuk nënkupton vetëm realizimin konkret të gjuhës, nëse i refrohem termave të Sosyrit, por edhe një realizimi të rrjedhshëm, përmes një të shqiptuari të pastër, të qartë, por edhe bukur. Sipas disa studiuesve “foshnjat lindin me një ndjeshmëri ndaj modeleve specifike ritmike të gjuhës njerëzore, dhe aftësinë për t'i përdorur ato”.

Poezia klasike nuk bazohej tek rima, por tek numri i rrokjeve. Rima u bë pjesë e poezisë me poezinë e re, poezinë silabike. Në Angli kjo traditë lidhet me emrin e Shekspirit. Në historinë e gjuhës shqipe ajo është pjesë që në krijimet në folklor. Këngët legjendare të cilat dallohen nga veriu në jug nga numri i rrokjeve. Në Veri vargjet janë më të gjata, kryesisht dhjetërokëshe, ndërsa në jug dhe tek arbëreshët mbizotëron tetërokëshi. Në këngët e veriu e të veriut janë të pasura me rimë, e cila zakonisht është e puthitur, ndërsa tek arbëreshët rima është më e rrallë:

Kjani, kjani, oj Zana, kjani/N' ato maje ku ju hani/

N'ato kroje ku ju pini/ n'ato hije ku ju rrini.

Pjesë e kësaj pasuri janë edhe ninullat. Karakteristikë e ninullave në gjuhën shqipe organizimi fonologjik është i tillë: “Rima e puthitur këmben vend me asonancën, por jo gjithmonë të pranishme që të dyja, në Jug e në Veri. Në ritmikën e këngëve shqiptare të djepit preferohet tetërokëshi, nganjëherë me rimë të brendshme” p.sh.

O, o, o, moj moll' Tivarit/ t'ka ble baba tesha ari (Shkodër)

Nina-nana, mollë e kuqe/ n' Elbasan ty do t'çoj nuse (Prishtinë)

Letërsia shqipe u mbështet fuqishëm në këtë krijimtari. Përmendim De Radën, Gj. Fishtë, B. Palaj etj. Kjo mbështetje tek Fishta vihet re në gjithë krijimtarinë e tij, por sidomos tek kryevepra e këtij shkrimtari, “Lahuta e Malcis”:

Ç'thoni burra? Fe e zakona,/ Bjeshkë e vrri e kullat t'ona,

A'imend Knjazit pa luftue,/ Pa 'i pushkë t'shtime kem m'ia lshue?

Vitet '80 të shek. XX për gjuhësinë shënojnë zhvillime të dukshme sidomos në teorinë prozodike (Selkirk 1980, 1984; Nespor & Vogel 1986; McCarthy & Prince 1986), por më tej u rrit interesi edhe për përfitim fonologjik (Kehoe & Stoel-Gammon 1997).

Ndërsa vitet e fundit pjesë e studimeve u bë roli i prozodisë në aftësinë e të lexuarit sidomos tek fëmijët (Ashby, 2006; Whalley & Hansen, 2006; Wood, 2006). Gjatë 8 viteve të para fëmijët mësojnë shumë për gjuhën dhe modulimet që mund të bëhen me anë të saj, prandaj edhe studimet janë përqendruar shumë për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve në moshën 3-10 vjeç. Kohët e fundit është studiuar lidhja mes ndjeshmërisë prozodike dhe aftësisë së të lexuarit nga perspektiva fonologjike. Në këtë zhvillim nga të gjitha proceset prozodike një vend të veçantë zë edhe rima.

Fëmijët që nga mosha 3-4 vjeç kanë njohuri për rimën dhe alternimet (Ch. Desforgers & R. Fox, 2002:38), por vëzhgime e bëra tregojnë se sa më shumë të jetë e zhvilluar kjo aftësi të rimuese, aq më të suksesshme do të jenë fëmijët në procesin e të lexuarit. Children with greater prosodic skills are superior in word reading accuracy and reading comprehension. (Whalley and Hansen (2006).

Rima si traditë

Duke parë rëndësinë e zhvillimit të aftësisë rimuese si parakusht për një të lexuar të suksesshëm, rekomandimet shkojnë për një punë bashkëvepruese mes prindit në shtëpi, si edukatori i parë gjuhësor i fëmijës, dhe mësuesit në klasë. Pse pikërisht prindi dhe ku duhet të përqendrohet vëmendja e tij?

Ninullat, këngët e para fëmija i dëgjon fillimisht nga prindërit dhe vecanërisht nga nëna. Përvec ëmbëlsisë që ata përcjellin përmes fjalës, ata janë të veshura me rimë. Shpesh mbi këtë bazë nëna krijon edhe ajo vetë vargjet për fëmijën e saj apo edhe epite të ndryshme, gjithmonë me alternime që tingullojnë pëlqyeshëm. Kjo e fundit në literatura njihet edhe me termin *rimë familjare*, për faktin sepse fëmija ndeshet për herë të parë me rimën në këtë ambient. Ai mëson nga të afërmit, kryesisht nga nëna, fjalë të thjeshta me rimë, sidomos fjalët në përkëdheli, si shq. *arush- lepurush*, *bukurosh- sykaltrush* etj. Me kalimin e kohës fëmija mëson elementet përbërëse të rimës p.sh në cuftin e fjalëve *mali- mami* vëren se fillojnë me të njëjtin tingull /m/; ndërsa po të krahasohet me ciftin tjetër: *mali-djali* identifikojnë se fjalët fillojnë me tinguj të ndryshëm: /m/, /d/. Në një stad më të zhvilluar fëmija me ndërgegje analizon strukturën e rrokjes e rrokjes p.sh *mal -fal* përbëhet nga onsets: /m/ /f/ dhe rima /al/. Më tej, kryen manipulime të ndryshme, me secilin përbërës të vecantë. (Adams 1990).

Fjalorët rimorë

Në ndihmë për një zhvillim gjuhësor të fëmijëve në këtë drejtim vinë *fjalorët e rimuar*. Ata i ndihmojnë fëmijët si për t'i shqiptuar saktë fjalët e dhëna sipas përbërjes fonemore të tyre, por edhe i japin shtysë të njohin fjalë të reja të afërta, por jo të njëjta me ta për nga shqiptimi. Kjo metodë i ndihmon fëmijët për një shqiptim korrekt, por edhe pasuron leksikut dhe i nxit ata të flasin bukur e të bëhen të nesërmen, pse jo, edhe poetë duke nxitur kështu zbulimin e talentit të të shkruarit. Kur lindën fjalorët rimorë dhe cila është tradita e tyre?

Fjalorët rimorë janë disa llojesh, por për fëmijët duhen më pak të ndërlikuara, duke marrë parasysh edhe moshën e fëmijës. Zakonisht janë fjalorë të cilët kanë fjalë që rimojnë në rrokjen e fundit, më tej në rrokjen e parafundit etj. Kur ata janë në variantin e printuar vështirësi mund të paraqesë shqiptimi, nëse ata janë me CD kjo gjë do t'i ndihmonte fëmijët për një shqiptim të standardizuar.

Në traditën italiane një pjesë e mirë e këtyre fjalorëve është hartuar si fjalorë shkrimtarësh a poetësh të njohur. Jo pak prej tyre lidhen me emrin e Dante Aligerit. I pari fjalor është hartuar Fulvio Pellegrino Moreto dhe mban titullin *Le Cadentie di Dante e Petrarca* (1528). Ai do të pasohet nga Girolamo Ruscelli me traktatin e tij *Del modo di comporre in versi nella lingua italiana* (1559), Benedetto di Falco (1535); Onofrio Bonozio di Verona (1556), Udeno Nisiely (1644); *Rimario universale* e Platania d'Antoni (Acireale 1892). Ndër botimet e shek. XX për veprën e Dantes një vend të vecantë zë botimi i Carlo Tagliavinit (1965) i përpunuar me metoda elektronike, paisur me konkordaca, rimar e leksik. Në Itali Roberto Busa në vitin 1951 botoi rezultatin e parë të leksikografisë elektronike në Itali.

Ndërsa tradita angleze e fjalorëve rimorë fillon me fjalorët dygjuhësh. I pari që hartoi një fjalor të tillë është Peter Levens i cili më 1570 botoi *Manipulus Vocabulorum: A Rhyming Dictionary of the English Language* me 9000 fjalë. “The Manipulus has a double interest, as at once an early collection of English words, and the first Rhyming Dictionary” (Preface, 1867: IV). Organizimi i rimës në këtë fjalor bëhet mbi bazën e zanores dhe të diftongut. I dyti në rend është Edward Bysshe (1702) i cili botoi *The Art of English Poetry: containing I. Rules for Making Verses. II. A Dictionary of Rhymes. III* me 3500 fjalë.

Në shek. XX tradita amerikane dhe ajo angleze lidhet me emrat: Burges Johnson, cili hartoi *New Rhyming Dictionary and Poet's Handbook* (1931); Clement Wood *The Complete Rhyming Dictionary and Poet's Craft Book* (1934); Frances Stillman, *The Poet's Manual and Rhyming Dictionary* (1966). Më të vona janë *The Penguin Rhyming Dictionary* (1985) nga Rosalind Fergusson. Më pas nisën të hartoheshin fjalorë rimarë për fëmijë. Sot mjaft të njohur janë: *Oxford Junior Rhyming Dictionary* (2005, 2009) përgatitur nga John Foster (Oxford University Press, *Barron's Junior Rhyming Dictionary* (2006) etj.

Në gjysmën e dytë të shek. XX zënë fill fjalorët rimorë në gjuhën franceze me autor J. de Fèvre I cili botoi *Dictionnaire de rimes françaises* (1571-1587). Për t'u pasuruar kjo traditë me: Odet de La Nouë *Dictionnaires des rimes franç. selon l'ordre des lettres de l'alphabet* (1596); Frémont d'Ablancourt *Dictionnaire de rimes avec histoire de la rime* (1667). Nga historiku i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX vecojmë punën e bërë nga L. Philippon *Dictionnaire portatif des rimes* (1805); N. Landais *Dictionnaire des rimes, avec un nouvel traité de versification* (1835:1853); Ch. Martinon, *Dictionnaire méthodique et pratique des rimes franc* (1905).

Me zhvillimet e disiplinave si sociolinguistika, dialektologjia lindën edhe fjalorë rimorë të zhargoneve. Disa prej të cilëve janë: P. , P. (1931/ 1932) *A Dictionary of Rhyming*; Franklyn, J. (1960) *A Dictionary of Rhyming Slang*; Jones, J. (1971) *Rhyming Cockney Slang* (2002); Ayto, J. (2002) *The Oxford Dictionary of Rhyming Slang*. etj.

Sot një pjesë e këtyre fjalorëve rimorë gjenden si në formatin e printuar, ashtu edhe on-line, gjë që ka lehtësuar shumë punën konsultuese me ta.

Tradita shqiptare

I pari fjalor i këtij lloji i botuar në gjuhën shqipe është *Fjalori rimor i Dritëro Agollit* i gjuhëtarit Mina Gero, (2013). Studiuesi Gero ka punuar me konceptin e rimemës, duke e parë atë në rrafshin morfologjik leksikor, pa lënë mënjane edhe pjesën që lidhet me konkordancat. Analizën e tij të rimemave autori e ka nisur me fjalët kyce, të cilat prezantohen jo thjesht me lemën përfaqësuese, siç mund të ndodhë në fjalorë të tjerë, por me disa fjalëforma të saj. Ndaj edhe analiza e kalon tek mbaresat, prapashtesat e mjete të tjera brenda fjalës.

Ndërsa i pari fjalor i hartuar, i cili deri tani ka mbetur akoma dorëshkrim është përgatitur nga studiuesi Kolë Ashta me titull *Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari* (Shkodër, 1955).¹ Ky fjalor rimar bazohet në krijimtarinë e poetit të njohur shkodran Ndre Mjeda. Mark Gurakuqi në veprën “Mbi veprën poetike të Mjedës. Studim” (Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980) është mbështetur në punimin e Ashtës kur ai diskuton për pasurinë e rimave të Mjedës. Për këtë ndihmesë në fund të bibliografisë, në zërin “Dorëshkrimi” shkruan: “Kolë Ashta “Rimari i Mjedës”, veprë, që autori pati mirësinë të na e japë për ta konsultuar dhe që është e para e këtij lloji” (f. 271).

Sa i takon hartimit të fjalorëve rimarë për fëmijë, mund të themi se kjo është një fushë akoma e pashkelur.

Puna me rimën

Unit rhyme nga pikëpamja e fonologjisë gjenerative është “the unit as consisting of everything between the last syllable corresponding to a certain height in the metrical grid and the end of the word, minus the onset of the first syllable” (Nespor & Vogel, 2007: 103).

Pra, fëmijët mësojnë që herët për tingujt, kombinimin e tyre në rrokje a fjalë, si dhe efektin që mund të krijojnë unitete të caktuara duke formuar rimë. Përveç asaj që ne e quajtmë *rimë familjare*, fëmijët mësojnë për rimën, mënyrën se si krijohet ajo në shkollë. Shkolla ka edhe misionin e kultivimit të të shprehurit me rimë. Ku duhet të përqendrohet puna e mësuesit?

Puna e mësuesit duhet të bazohet fillimisht tek krahasimi. Mësuesi duhet t’i pyesë fëmijët herë pas here se çfarë dallimi vënë re ata kur lexojnë një poezi duke e krahasuar atë tingull në të folurit e zakonshëm, duke e bërë fëmijën të vëmendshëm ndaj uniteteve që janë mbartëse të rimës. Vjershat me rimë e ndihmojnë fëmijën për artikulimin e tingujve, edhe për memorien. Në një fazë tjetër puna duhet të fokusohet në dallimin e rimave mashkullore, femërore dhe kur ata dalin të zgjeruara:

Rima **mashkullore**: *ari~ bari, mali~ djali, deti~poeti* etj.

femërore: *dera ~ era, vera~era, dita ~drita, fusha~arusha* etj.

e zgjeruar: *malor~ djalor, botëror malor, detar~peshkatar* etj.

Fëmijët e kanë më të thjeshtë dallimin e rimës në rimat emërore kur emri del në trajtë të shquar dhe në rasën përfaqësuese. Më pas ai kapërcen në rasat e tjera: *botën~gotën, djalin~malin* etj.

¹ Ky fjalor rimar bazohet në krijimtarinë e poetit të njohur shkodran Ndre Mjeda.

Fillimisht operohet me fjalë të thjeshta për nga përbërja e tyre për të kaluar në fjalë të përbëra, si: *hekurudhë~këpurdhë, vendlindje~mikpritje* etj. Në këtë mënyrë veprohet edhe me rimat folore duke nisur me forma të thejshta vepropre, më pas në forma pësore e më të ndërlikuara p.sh: *di~rri, dal ~fal, afro~largoj, afrohet ~largohe, bleron~loto etj.*

Kur fëmijët dëgjojnë një vjershë me rimë shpesh ata ndeshen edhe me fjalë të reja pra i ndihmon të pasurojnë fjalorin.

Teknologjia

Si në cdo hap të metodologjisë së të mësuarit edhe në këtë rast një ndihmë e madhe mund të vijë nga teknologjia. Jo vetëm televizori që është ndër të parat mjete elektronike me të cilin ballafaqohet fëmija, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive të fëmijëve, por edhe mjaft të tjera

Por sërsish mësuesi është i pari që duhet të propozojë këto metoda e pastaj fëmijët mund të bëhen të pavarur në përdorimin e tyre. Puna e mësuesit duhet të jetë sistematike në këtë drejtim. Ata duhet t'i nxisin fëmijët vazhdimisht që të gjejnë fjalë që rimojnë dhe nuk është e rëndësishme nëse ata i shkruajnë në dërrasë të zezë, në bllokun e shënimeve, në kompjuter etj.

Duke qenë se fëmijët sot janë shumë të tërhequr drejt kompjuterit, atëherë ky i fundit mund të përdoret në mbajtjen e shënimeve, për të rimuar fjalë a fjali; të navigojnë duke gjetur vjersha a këngë me rimë. Një pjesë e tyre janë të shakrkushme edhe për smarphone e tablet. Këto metoda ai duhet t'i propozojë edhe prindërve që t'i përdorin në shtëpi me fëmijët e tyre.

Përfundime dhe rekomandime

Teknologjia është një mjet që na ndihmon të mësojmë edhe gjuhën në ët gjitha nënsistemet e saj më me lehtësi. Mësuesit duhet ta mbështesin përfshirjen e ICTS në mësimdhënie. Të mësuarit e gjuhës, aftësia e të rimuarit nuk mund të konsiderohet tani një privilegj vetëm për një pjesë të fëmijëve, por duhet të jetë e drejtë për të gjithë. Këtë e realizon jo vetëm puna e mësuesit, por sidomos puna e pavarur mjete elektronike. Për këtë qëllim mund të ndërtohen fjalorë rimorë, të konsultueshëm edhe *on line*. Eksperincat e gjuhëve të tjera duhet të na ndihmojnë me ide për hartimin e quizeve, lojërave të cilat kanë në qendër lojën me fjalën, me rimën. Nuk duhet të përjashtohen këtu edhe lojëra me këtë tematikë në formatin e printuar. Një model i mirë është *VocabularySpellingCity*, krijuar në marsin e viti 2012 duke u mbështetur në teknologjitë moderne.

Mund të përpilohen edhe fjalorë shkollorë për fëmijë (Junior School Dictionary), ku të përfshihen fjalët me familjen e tyre, mundësuar edhe dallimet mes homofoneve. Këto fjalorë do t'i ndihmonin fëmijët për shqiptimin e saktë të fjalëve, por edhe njohjen e semanticës së fjalëve. Të gjitha këto mjete duhet ta ndihmojnë fëmijët të kalojnë nga kompetecë fonologjike në një vetëdije fonologjike. Kjo kërkon edhe pasurimin e kurrikulës me këto elemente.